



Viti i XVI-të i Botimit, Nr.2

Dhjetor 2024

FENOMENI I DHUNËS KIBERTINIKE DHE PROBLEMATIKAT AKTUALE TË MBROJTJES JURIDIKO PENALE NDAJ SAJ

Ylli Pjetërnikaj*, Enisa Shahini**

**Prosecutor at the Prosecution Office of First Instance Court of General Jurisdiction - Tirana*

***Judge at First Instance Administrative Court - Tirana*

Përmbledhje

Dhuna kibernetike duke qenë një fenomen relativisht i ri, i cili përfshin një shumëllojshmëri të gjerë krimesh, si term është ende i vështirë për t'u përcaktuar me saktësi. Ajo shpesh keqkuptohet dhe nuk merret seriozisht sa duhet. Megjithatë, mund të fillojë në internet, por shpesh përfundon jashtë realitetit kibernetik me pasoja shkatërruese për viktimat dhe familjet e tyre. Kërcënimet për dhunë, përndjekje, nxitje për vetëvrasje, tërheqje të fëmijëve për qëllime seksuale, të gjitha mund të rezultojnë në vetëlëndimin e viktimës, ose në sulmin fizik nga autori fillestar. Është e rëndësishme të veprohet për të parandaluar shfaqjen e dhunës kibernetike dhe për të mbrojtur e sjellë drejtësi për viktimat.

Shumica e vendeve po përpiqen të njohin aspektet e ndryshme të problemit dhe t'i adresojnë ato në ligjin e tyre të brendshëm. Disa prej tyre kanë ligje që trajtojnë në mënyrë specifike forma të veçanta të dhunës kibernetike. Megjithëse dhuna kibernetike ekziston prej disa vitesh, format e saj specifike duket se kanë filluar të identifikohen dhe kuptohen vetëm kohët e fundit.

Disa lloje të dhunës kibernetike trajtohen plotësisht, ose pjesërisht në marrëveshjet ndërkombëtare, por shumë prej tyre mbeten përsëri të pa adresuara. Prandaj Këshilli i Evropës po punon në të gjithë sektorët e tij (për shembull, përmes mekanizmave që lidhen me Konventën e Budapestit, Konventën e Stambollit dhe Konventën e Lanzarotes) për të siguruar që të drejtat e njeriut të respektohen edhe në hapësirën kibernetike, për të gjithë. Është e rëndësishme të theksojmë se shumë forma të dhunës kibernetike janë tashmë të adresuara në ligjin vendas ose ndërkombëtar nga dispozitat e «botës fizike» dhe hetimet penale nuk duhet të presin vetëm legjislacionin e ri. Kështu, kur kompjuterët përdoren për të shkakuar ose lehtësuar dhunën nëpërmjet transmetimit të mesazheve që shkaktojnë dëme psikologjike, ose nëpërmjet reklamave për vrasje, përdhunim, rrëmbim ose trafikim të qenieve njerëzore, raste të tilla mund të ndiqen penalisht (në varësi të fakteve të tyre) si sulm, shkelje e privatësisë, kanosje, zhvatje, pornografi, ose vrasje, përndjekja, dhuna në familje, etj. Në këtë punim do të fokusohemi tek shfaqja e fenomenit të dhunës kibernetike në Shqipëri, adresimi ligjor i saj, duke identifikuar problematikat përkatesë, dhe nevojat për ndërhyrje.

Fjalë çelës: kibernetike, dhuna, krim, ligji penal, konventa

THE PHENOMENON OF CYBER VIOLENCE AND THE CURRENT PROBLEMS OF CRIMINAL LEGAL PROTECTION AGAINST IT

Abstract

Cyber violence, being a relatively new phenomenon and which includes a wide variety of crimes, as a term in itself is still difficult to be precisely defined. It is often misunderstood and not taken seriously enough. However, it may start online through internet, but often ends up outside cyber reality with devastating consequences for the victims and their families. Threats of violence, stalking, incitement to suicide, attraction of children for sexual purposes, etc. can all result in the victim's self-harm, or physical assault by the original perpetrator. It is important to act in order to prevent cyber violence from occurring, as well as to protect the victims and bring the perpetrators before justice.

Most countries are trying to recognize and acknowledge the different aspects of this phenomenon, and address them in their domestic laws. Some of them have laws that specifically address particular forms of cyber violence. Although cyberbullying has existed for several years, its specific forms seem to have only recently begun to be identified and understood.

Some types of cyber violence are fully or partially addressed in international agreements, but many of them still remain unaddressed. The Council of Europe is therefore working in all its sectors (for example, through mechanisms related to the Budapest Convention, the Istanbul Convention and the Lanzarote Convention) to ensure that human rights are respected for all, even in cyberspace. It is important to note that many forms of cyber-violence are already addressed in domestic or international laws by "physical world" provisions, and criminal investigations should not wait for new legislation. Thus, when computers are used to cause or facilitate violence by transmitting messages that cause psychological harm, or by advertising murder, rape, kidnapping or human trafficking, such cases may be penally prosecuted (depending on the facts) under the provisions of assault, invasion of privacy, threats, extortion, pornography, or murder, stalking, domestic violence, etc.

In this paper we will focus on the appearance of the phenomenon of cyber violence in Albania, the legal addressing of this phenomenon through the identification of its relevant problematics, as well as the need for intervention.

Keywords: *Cyber, violence, crime, criminal law, convention*

1. Përpjekja për të definuar fenomenin e dhunës kibernetike

Aktet e dhunës ndaj individëve të kryera me anë ose të ndihmuara nga teknologjitë e informacionit dhe komunikimit, e identifikuar me termin "*dhuna kibernetike*" janë bërë shqetësimi kryesor për shoqëritë dhe individët në të gjitha vendet e botës. Dhuna kibernetike duke qenë një fenomen relativisht i ri, i cili përfshin shumëllojshmëri të gjerë krimesh, posibilitet për gjërësi të dukurive të saj, diversitet i kategorive dhe nën-kategorive, koncepti për të është ende i vështirë për t'u përcaktuar me saktësi. Grupi i Punës i T-CY¹ për bullizmin kibernetik dhe format e tjera të dhunës, në studimin

1 Komiteti i Konventës për Krimet Kibernetike (T-CY) përfaqëson shtetet palë në Konventën e Budapestit (Këshillit të Europës) për krimin kibernetik. Bazuar në nenin 46 të Konventës, konsultimi i Komitetit synon të lehtësojë përdorimin dhe zbatimin efektiv të Konventës, shkëmbimin e informacionit dhe shqyrtimin e çdo amendamenti të ardhshëm. T-CY 16 (Strasburg, Nëntor 2016), vendosi krijimin e një Grupi Pune T-CY për bullizmin kibernetik dhe format e tjera të dhunës në internet,

e tij “Hartëzimi mbi Dhunën Kibernetike”², arriti konsensus për përdorimin e “*dhunës kibernetike*” si termin më konciz, duke e përcaktuar³ si: “*Përdorimi i sistemeve kompjuterike për të shkaktuar, lehtësuar ose kërcënuar dhunën kundër individëve, që rezulton (ose ka të ngjarë të rezultojë në) dëm ose vuajtje fizike, seksuale, psikologjike ose ekonomike dhe mund të përfshijë shfrytëzimin e rrethave, karakteristikave ose dobësive të individit..*”⁴

Dhënia e një definimi për të paraqet rëndësi të madhë për fokusimin dhe adresimin e saj. Përparësitë e përcaktimit dhe klasifikimit të dhunës kibernetike përfshijnë lehtësimin e njohjes dhe emërtimit të sjelljeve kur ato ndodhin; lejimin e artikulimit të strategjive të rezistencës dhe veprimeve kundërvepruese që janë përshtatur me kërkesat e secilit; dallimin e dhunës kibernetike nga forma të tjera, më pak serioze të sjelljes së “bezdisshme” në internet; zbulimin e marrëdhënieve themelore midis dhunës kibernetike dhe fenomeneve të tjera, të tilla si pornografia, të cilat ndryshe mund të mos zbulohen, duke na ndihmuar të vendosim dhunën kibernetike brenda një perspektive më të gjerë.⁵

Përveç përpjekjeve të tilla institucionale, si ajo e sipërpërmendur, në doktrinë autorë të ndryshëm kanë dhënë definime për termin “*dhuna kibernetike*”. Kështu disa prej tyre e përkufizojnë atë si sjellje në internet, që përbën ose çon në sulm kundër mirëqenies (fizike, psikologjike, emocionale) të një individi ose grupi.⁶ Sipas këtyre studiuësve ajo që dallon dhunën kibernetike nga format tradicionale veçanërisht kundër grave dhe fëmijëve – bazuar në nenin 1.1.j të Rregullores së Procedurës T-CY, si dhetë ngarkojë atë të studiojë temën në formën e një ushtrimi hartografik, duke përfshirë qasjet krahasuese ndaj legjislacionit si dhe dokumentimin e praktikave të mira në funksion të paraqitjes së rezultateve të ndërmjetme në Plenaren e 17-të dhe një raport përfundimtar në Plenarin e 18-të të T-CY. Më pas Plenari i 18-të në nëntor 2017 vendosi të zgjasë mandatin e Grupit të Punës deri më 31 korrik 2018 dhe t'i kërkojë Grupit të paraqesë një draft përfundimtar të studimit të hartës në T-CY 19 (korrik 2018), si dhe të lehtësojë një seminar mbi këtë temë në Konferencën e Oktapodit në korrik 2018.

2 Shih: Cybercrime Convention Committee (T-CY), Working Group on cyberbullying and other forms of online violence, especially against women and children, “Mapping study on cyberviolence” with recommendations adopted by the T-CY on 9 July 2018, fq 5.

3 Ky përkufizim pune është një përshtatje e kontekstit “kibernetik” të përkufizimit të dhunës ndaj grave sipas nenit 3 të Konventës së Stambollit që e përkufizon atë si shkelje të të drejtave të njeriut dhe një formë diskriminimi ndaj grave dhe do të nënkuptojë të gjitha aktet gjinore- dhunë e bazuar në, ose ka të ngjarë të rezultojë në, dëmtime ose vuajtje fizike, seksuale, psikologjike ose ekonomike për gratë, duke përfshirë kërcënimet për akte të tilla, detyrimin ose privimin arbitrar të lirisë, qoftë në jetën publike ose private.

Në mënyrë të ngjashme, neni 1 i Konventës Ndër-Amerikane për parandalimin, ndëshkimin dhe çrrënjosjen e dhunës ndaj grave (Konventa Belém do Para) e përcakton dhunën ndaj grave si: çdo veprim ose sjellje, bazuar në gjini, që shkakton vdekje ose dëmtime ose vuajtje fizike, seksuale ose psikologjike për gratë, qoftë në sferën publike ose private.

Një përkufizim gjithëpërfshirës i dhunës ndaj grave është dhënë gjithashtu nga Kombet e Bashkuara: “Çdo akt i dhunës me bazë gjinore që rezulton ose ka të ngjarë të rezultojë në dëmtime ose vuajtje fizike, seksuale ose psikologjike ndaj grave, duke përfshirë kërcënimet për akte të tilla, detyrimin ose privimin arbitrar të lirisë, qoftë në jetën publike ose private”. <http://www.un.org/womenwatch/daw/vaw/v-overview.htm>. E përbashkët për të gjitha këto përkufizime është se «dhuna» nuk kufizohet në dëmtim fizik. Anëtarët e Grupit të Punës pranojnë se ky përkufizim pune është mjaft i gjerë dhe duhet të maturohet më tej. Nga ana tjetër, është realitet që çdo krim mund të ketë një element “kibernetik” që mund të ndryshojë natyrën dhe shtrirjen e krimit.

4 Shih: <https://www.coe.int/en/web/cyberviolence>

5 Shih:Herring, Susan C. (2002). “Cyber Violence: Recognizing and Resisting Abuse in Online Environments. *Asian Women* 14 (Summer): 187-212, Indiana University, Bloomington USA.

6 Shih: Herring, Susan C. (2002). “Cyber Violence: Recognizing and Resisting Abuse in Online

të dhunës *offline* është se në të parën, një pjesë e rëndësishme e sjelljes ndodh në internet, megjithëse mund të kalojë më pas në kontekste *offline*. Kështu, dhuna kibernetike mund, por nuk është e nevojshme, të ketë një komponent fizik, dhe shumë nga dëmet e shkaktuara, ashtu si nga dhuna *offline*, janë të natyrës psikologjike dhe/ose emocionale, por nuk do të thotë më pak reale ose shkatërruese. Së fundi, dhuna kibernetike mund të synohet ndaj individëve ose grupeve, të cilët janë objektiva më karakteristik të dhunës kibernetike sesa të dhunës fizike, për shkak të lehtësisë me të cilën një autor i vetëm mund të mbledhë informacione dhe të kontaktojë me një numër të madh njerëzish në internet. Ky është një aspekt tjetër i dhunës në internet që mund të bëjë që ajo të ketë efekte të përhapura.⁷

UN Ëomen konsideron dhunë kibernetike kur një person (ose grup personash) përdor një pajisje të lidhur në internet për të shkaktuar dëmtime seksuale, psikologjike, ekonomike ose të tjera, shpesh duke shfrytëzuar rrethanat, karakteristikat ose dobësitë e targetit të tyre. Dhuna kibernetike shpesh mund të çojë në dëmtim të drejtpërdrejtë fizik. Megjithëse çdokush mund të përjetojë dhunë kibernetike, gratë dhe vajzat janë në rrezik më të madh, veçanërisht ndaj ngacmimeve të rënda dhe abuzimeve seksuale⁸.

Sekretariati i Komunielthit në raportin e tij CVAËG (Cyber Violence Against Women and Girls), e përkufizon dhunën kibernetike si një akt i GBV-së (Gender Based Violence) i kryer drejtpërdrejt ose tërthorazi përmes teknologjive të informacionit dhe komunikimit që rezulton në, ose ka të ngjarë të rezultojë në, dëmtime ose vuajtje fizike, seksuale, psikologjike ose ekonomike për gratë dhe vajzat, duke përfshirë kërcënime të tilla, qofshin ato që ndodhin në jetën publike ose private, apo pengesa për përdorimin e të drejtave dhe lirive të tyre themelore.⁹ CVAËG nuk është i kufizuar, por përfshin shkelje të privatësisë, ndjekje, ngacmim, gjuhë të urrejtjes me bazë gjinore, ndarje personale të përmbajtjes pa pëlqim, abuzimi seksual i bazuar në imazhe, hakimi, vjedhja e identitetit dhe dhuna e drejtpërdrejtë. Dhuna kibernetike është pjesë e vazhdimësisë së VAË (Violence Against Women), sepse ajo nuk ekziston në vakum, përkundrazi, buron dhe mban forma të shumta të dhunës *offline*.¹⁰

Ky përkufizim është gjithëpërfshirës dhe mbetet i gjerë mjaftueshëm për të përfshirë të gjitha format e dhunës kibernetike, duke pranuar vazhdimësinë e VAË midis mjediseve *offline* dhe *online*, si dhe format e ndryshme të dëmtimit të përjetuara nga viktimat. Megjithatë, ai nuk është një përkufizim detyrues dhe nuk përmend në mënyrë eksplicite vajzat, të cilat janë përdorueset të zellshme të teknologjive dixhitale dhe shpesh janë në shënjestër disproporcionale të abuzimit, si një grup i veçantë viktimash.¹¹

Environments. *Asian Women* 14 (Summer): 187-212, Indiana University, Bloomington USA.

7 Po aty.

8 Shih: A Guide for Women and Girls to Prevent and Respond to Cyber violence, 2021 UN Women, fq 4. This guidance note has been produced by UN Women and UNICEF under the joint UN project 'Accelerating Women's Empowerment for Economic Resilience and Renewal: The post-COVID-19 reboot in Armenia', implemented by UNDP, UNIDO, UNICEF and UN Women.

9 "Addressing Online Violence Against Women and Girls in the Commonwealth Europe Region The Role of Bystanders", © Commonwealth Secretariat 2023, fq 8. Ky raport kontribuon në studimin e Commonwealth mbi dhunën në internet kundër grave dhe vajzave (OVAWG) dhe merr në konsideratë prevalencën e dhunës në internet dhe rolin e kalimtarëve, si dhe ligjet, institucionet, politikat dhe praktikën përkatëse për të adresuar problemin në rajonin evropian të Commonwealth, përkatësisht Qipron, Maltën dhe Mbretëria e Bashkuar e Britanisë së Madhe (Anglia, Skocia dhe Uells) dhe Irlanda e Veriut (MB).

10 Shih Scottish Government (2020) Preventing violence against women and girls - what works: evidence summary. Available from <https://www.gov.scot/publications/works-prevent-violence-against-women-girls-summary-evidence/pages/6/>. Accessed 14 March 2024.

11 Shih: EIGE (European Institute for Gender Equality (2022b), 'Cyber violence against women', available at: <https://eige.europa.eu/gender-based-violence/cyber-violence-against-women> (ac-

Gjithashtu të njëjtin qëndrim ka mbajtur edhe Komiteti Këshillimor për Mundësi të Barabarta për Gratë dhe Burrat, i cili e definon dhunën kibernetike ndaj grave si një akt dhune i bazuar në gjini, e ushtruar drejtpërdrejt ose tërthorazi nëpërmjet informacionit dhe teknologjitë e komunikimit që rezultojnë në, ose ka të ngjarë të rezultojë në dëmtim fizik, seksual, psikologjik ose ekonomik ose vuajtjet ndaj grave dhe vajzave, duke përfshirë kërcënimet për akte të tilla qoftë në jetën publike apo private, ose pengesa për përdorimin e të drejtave dhe lirive të tyre themelore. Dhuna kibernetike ndaj grave nuk kufizohet vetëm në, por përfshin shkelje të privatësisë, ndjekje, ngacmim, gjuhë të urrejtjes me bazë gjinore, ndarje të përmbajtjes personale pa pëlqim, abuzim seksual të bazuar në imazhe, hakerim, vjedhje identiteti dhe dhunë të drejtpërdrejtë. Dhuna kibernetike është pjesë e vazhdimësisë së dhunës ndaj grave: ajo nuk ekziston në vakum; përkundrazi, ajo buron dhe mbështet forma të shumta të dhunës jashtë linje.¹²

Dhuna kibernetike, shpesh, keqkuptohet dhe nuk merret aq seriozisht sa duhet. Megjithatë, është e rëndësishme të theksohet se dhuna kibernetike mund të fillojë në internet, por shpesh përfundon jashtë linje me pasoja shkatërruese për viktimat dhe familjet e tyre. Kërcënimet për dhunë, përndjekje, nxitje për vetëvrasje, tërheqje të fëmijëve për qëllime seksuale, të gjitha mund të rezultojnë në vetëlëndimin e viktimës ose në sulmin fizik nga autori fillestar. Është e rëndësishme të veprohet për të parandaluar shfaqjen e dhunës kibernetike dhe për të mbrojtur dhe sjellë drejtësi për viktimat.¹³

Megjithatë, shumica e vendeve po përpiqen të njohin aspektet e ndryshme të problemit dhe t'i trajtojnë ato në ligjin e brendshëm. Disa lloje të dhunës kibernetike trajtohen plotësisht ose pjesërisht në marrëveshjet ndërkombëtare, por shumë mbeten të pa adresuara. Këshilli i Evropës po punon në të gjithë sektorët (për shembull, përmes mekanizmave që lidhen me Konventën e Budapestit, Konventën e Stambollit dhe Konventën e Lanzarotes) për të siguruar që të drejtat e njeriut të respektohen edhe në hapësirën kibernetike, për të gjithë.¹⁴

Informacioni i marrë nga shtetet anetare sugjeron se disa vende kanë ligje që trajtojnë në mënyrë specifike forma të veçanta të dhunës kibernetike. Megjithëse dhuna kibernetike ekziston prej disa vitesh, format e saj specifike duket se kanë filluar të identifikohen dhe kuptohen vetëm kohët e fundit. Shumica e vendeve po luftojnë për të njohur aspektet e ndryshme të problemit dhe për t'i trajtuar ato në ligjin e brendshëm.¹⁵

2. Standartet e GJEDNJ-së mbi dhunën kibernetike

Është e rëndësishme të theksojmë se shumë forma, apo tipologji të dhunës kibernetike janë tashmë të mbuluara në ligjin vendas ose ndërkombëtar nga dispozitat që normojnë “botën fizike” dhe he-

cessed 01 may 2024).

12 Opinion on combatting online violence against women, European Commission Advisory Committee on Equal Opportunities for Women and Men, April 2020.

13 Shih: Cybercrime Convention Committee (T-CY), Working Group on cyberbullying and other forms of online violence, especially against women and children, “Mapping study on cyberviolence” with recommendations adopted by the T-CY on 9 July 2018, fq 5.

14 Cybercrime Convention Committee (T-CY) Working Group on cyberbullying and other forms of online violence, especially against women and children Mapping study on cyberviolence with recommendations adopted by the T-CY on 9 July 2018.

15 Cybercrime Convention Committee (T-CY) Working Group on cyberbullying and other forms of online violence, especially against women and children Mapping study on cyberviolence with recommendations adopted by the T-CY on 9 July 2018, fq 5

timet mund të mos presin, apo stopohen për mungesë legjislacioni. Për shembull, kur kompjuterët përdoren për të shkaktuar ose lehtësuar dhunën nëpërmjet transmetimit të mesazheve, që shkaktajnë dëme psikologjike, ose nëpërmjet reklamave për vrasje, përdhunim, rrëmbim ose trafikim të qenieve njerëzore, raste të tilla mund të ndiqen penalisht (në varësi të fakteve të tyre) si përndjekje, shkelje e privatësisë, kanosje, zhvatje, nxitje përdhunimi ose vrasje, shpërndarja e paligjshme e përmbajtjes (si fotografite), dhuna në familje, etj. Ky është orientim edhe i praktikës së fundit të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njërit, e cila ka identifikuar fenomenin e dhunës kibernetike, ka dhënë një definicion për të, si dhe ka vendosur standartet që duhet të respektohen nga shtetet për adresimin e tij. Sipas saj “cyberviolence” është përdorimi i sistemeve kompjuterike për të shkaktuar, lehtësuar ose kërcënuar dhunën ndaj individëve apo grupeve, duke shkaktuar dëme ose vuajtje fizike, seksuale, psikologjike ose ekonomike. Kjo është arsyeja pse Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njërit e ka përfshirë atë midis formave të dhunës në familje.¹⁶ Format e reja të dhunës kibernetike po përhapen, prandaj duhet të përqendrohem në vendimin novator të GJEDNJ, i cili e përfshiu atë mes hipotezave të dhunës në familje.¹⁷

Në veçanti, sipas Gjykatës¹⁸, rastet e dhunës kibernetike si aksesit në të dhënat e ndjeshme të viktimës dhe llogaritë private, gjithashtu, hyjnë në fushën e dhunës në familje. Për rrjedhojë, Shtetet Palë në Konventë duhet të marrin të gjitha masat e nevojshme për të përmbushur detyrimet pozitive të vendosura nga Konventa Evropiane në rastet e dhunës ndaj grave. Në rastet e dhunës në familje, autoritetet kombëtare duhet të refuzojnë një qasje thjesht formaliste dhe të sigurojnë se masat mbrojtëse të marra janë efektive.

Aktet e dhunës kibernetike, ngacmimi kibernetik dhe imitimi me qëllim të keq janë kategorizuar, nga Gjendnj si forma të dhunës kundër grave dhe fëmijëve të afta të minojnë integritetin e tyre fizik dhe psikologjik për shkak të cenueshmërisë së tyre.¹⁹ Gjykata ka vënë në dukje kohët e fundit se “ngacmimi kibernetik njihet aktualisht si një aspekt i dhunës ndaj grave dhe vajzave dhe mund të marrë forma të ndryshme, të tilla si shkeljet kibernetike të jetës private, dhe marrja, shkëmbimi dhe trajtimi i informacionit dhe imazhe, duke përfshirë ato intime”. Në kontekstin e dhunës në familje, partnerët intimë janë shpesh autorë të mundshëm të akteve të përndjekjes ose përgjimit kibernetik.²⁰

Dhuna në internet, ose dhuna kibernetike, është e lidhur ngushtë me dhunën jashtë linje ose “të jetës reale” dhe konsiderohet si një aspekt tjetër i fenomenit kompleks të dhunës në familje.²¹ Shtetet kanë një detyrim pozitiv për të krijuar dhe zbatuar në mënyrë efektive një sistem që ndëshkon të gjitha format e dhunës në familje dhe për të ofruar garanci të mjaftueshme për viktimat.²² Detyrimi pozitiv vlen për të gjitha format e dhunës në familje, qofshin ato jashtë linje apo online.

Gjendnj ka vlerësuar se publikimi i fotografive intime të kërkueses “minoit dinjitetin e saj, duke përcjellë një mesazh poshtërimi dhe mosrespektimi”.²³ Publikimi jo konsensual i fotografive të saj intime,

16 Shih: GJEDNJ çështja e Buturugă v. Romania (application no. 56867/15). ECHR 056 (2020) 10.02.2020.

17 Shih: Edoardo Buffagni “La cyberviolenza è una forma di violenza domestica: come affrontarla” Pubblicato il 10 Feb 2022, [La cyberviolenza è una forma di violenza domestica: come affrontarla - Agenda Digitale](#).

18 Shih: GJEDNJ çështja e Volodinës vs. Rusisë 14/12/2021

19 Shih: KU kundër Finlandës, nr. 2872/02, § 41, GJEDNJ 2008.

20 Shih: GJEDNJ çështja e Buturugă v. Romania (application no. 56867/15). ECHR 056 (2020) 10.02.2020.

21 Shih Buturugă, cituar më lart, §§ 74 dhe 78, dhe paragrafin 20 më lart

22 Shih: çështjet Opuz kundër Turqisë, nr. 33401/02, § 145, ECHR 2009, dhe Bălşan k. Rumania, nr. 49645/09, § 57, 23 maj 2017

23 Shih: GJEDNJ, çështja e Volodinës vs. Rusisë 14/12/2021, cituar më sipër, § 75

krijimi i profileve të rreme në mediat sociale që pretendohej se e imitonin atë, dhe gjurmimi i saj me përdorimin e një pajisjeje GPS ndërhyrë në gëzimin e saj në jetën e saj private, duke e shkaktuar atë të ndiejë ankth, dhe pasiguri. Rrjedhimisht, duhet të përcaktohet nëse autoritetet, pasi kanë marrë dijeni për ndërhyrjen në të drejtat e njëriut sipas nenit 8 të Konventës, kanë përmbushur detyrimet e tyre sipas kësaj dispozite për të marrë masa të mjaftueshme për t'i dhënë fund asaj ndërhyrje dhe për të parandaluar përsëritjen e saj.²⁴

Gjykata së pari do të shqyrtojë nëse shteti i paditur ka krijuar një kuadër ligjor të përshtatshëm që i siguron kërkuarit mbrojtje kundër akteve të dhunës kibernetike.²⁵ Ajo përsërit se, për sa i përket akteve që cenojnë integritetin psikologjik të një individi, detyrimi i një kuadri ligjor adekuat nuk kërkon, gjithmonë, vendosjen e një dispozite të ligjit penal që mbulon veprën specifike. Kuadri ligjor mund të përbëhet, gjithashtu, nga mjete juridike të së drejtës civile të afta për të ofruar mbrojtje të mjaftueshme, mundësisht të kombinuara me mjete juridike procedurale siç është dhënia e një urdhri mbrotjeje.²⁶

Gjykata vlerëson se aktet e dhunës kibernetike që janë “mjaft” serioze për të kërkuar një përgjigje penale nga ana e autoriteteve vendase. Publikimi i fotografive intime të kërkuarës, të llogaritura për të tërhequr vëmendjen e djalit të saj, shokëve të klasës dhe mësueses së tyre, synonte ta poshtëronte dhe degradonte atë. Siç u theksua më lart, gjurmimi i lëvizjeve të saj me anë të një pajisjeje GPS dhe dërgimi i kërcënimeve me vdekje në rrjetet sociale i shkaktuan asaj ankth, shqetësim dhe pasiguri. Gjykata rithekson, gjithashtu, se si interesi publik ashtu edhe interesi i mbrojtjes së viktimave të cenueshme nga veprat penale që cenojnë integritetin e tyre fizik ose psikologjik kërkojnë disponueshmërinë e një mjeti juridik që mundëson identifikimin e autorit dhe sjelljen para drejtësisë.²⁷

Si përmbledhje, Gjykata konstaton se, edhe pse kuadri ekzistues i pajisi autoritetet me mjete ligjore për të ndjekur penalisht aktet e dhunës kibernetike, viktimë e të cilave kërkuarë ishte, mënyra në të cilën ata e trajtuan në të vërtetë çështjen, e veçanërisht një hezitim për të hapur një çështje penale dhe një ritëm i ngadaltë i hetimit që rezultoi në mosndëshkimin e autorit, zbuloi një dështim për të përmbushur detyrimet e tyre pozitive sipas nenit 8 të KEDNJ, duke sjellë rrjedhimisht, shkelje të kësaj dispozite.²⁸

Për më tepër, duke pasur parasysh varësinë nga sistemet kompjuterike, duke përfshirë varësinë psikologjike, fizike dhe ekonomike, disa lloje të krimit kibernetik (qasja e paligjshme në të dhënat personale intime, shkatërrimi i të dhënave, etj.) mund të konsiderohen, gjithashtu, akte të dhunës kibernetike. Ligjet për krimin kibernetik mund të zbatohen veçanërisht kur shkaktohet dhuna si lëndimi ose vdekja, për shembull, nëpërmjet sulmeve të bazuara në kompjuter kundër infrastrukturës kritike, ose pajisjeve mjekësore. Fusha e veprimtimit të të ashtuquajturës “cyberviolence” përfshin një shumësi sjelljesh të dhunshme dhe agresive ndaj të tjerëve dhe, në veçanti, ndaj individëve të pambrojtur.²⁹

Kjo çon në një reflektim të dyfishtë, i cili përqendrohet, nga njëra anë, në llojet e reja të dhunës, apo mënyrat e jashtme të saj, të tilla si përndjekja, ngacmimi kibernetik, bullizimi, apo pornografia hakmarrëse (edhe pse mbeten dyshime të konsiderueshme për sa i përket përshtatshmërisë së kësaj zgjedhjeje të terminologjisë). Nga ana tjetër, mbi zhvillimin dhe konfigurimin e konceptit, domos-

24 Shih: Eremia, cituar më sipër, § 75

25 Shih: *Söderman*, cituar më lart, § 89-91

26 Po aty, §§ 85 dhe 108, me referenca të mëtejshme

27 Shih: KU kundër Finlandës, cituar më lart, § 47, dhe Volodina, cituar më lart, § 100)

28 Shih: **GJEDNJÇështja e Volodinës vs. Ruisë 14/12/2021**

29 Shih: F. Di Tano, I reati informatic e i fenomeni del cyberstalking, del cyberbullismo e del revenge porn, in Th. Casadei, S. Pietropaoli [a cura di], *Diritto e tecnologie informatiche. Questioni di informatica giuridica, prospettive istituzionali e sfide sociali*, Wolters-Kluwer, Cedam giuridica, Milano, 2021, fq. 165-178

doshmërisht për t'u përshtatur me karakteristikat e kontekstit të ri në shqyrtim, të ashtuquajturës “cyberspace”.³⁰ Nga ky këndvështrim, cyberspace është një mjet lehtësues duke iu referuar kryerjes së veprave të paligjshme, për shkak të lehtësisë më të madhe me të cilën lejon të arrijë viktimën, e cila, në ditët e sotme, është pothuajse gjithmonë një subjekt që zakonisht përdor pajisje, duke funksionuar nga lidhja me rrjetin dhe, për këtë arsye, në vendin e zbatimit të sjelljes së paligjshme dhe në të cilën kriminelin pret viktimën e tij.

Cyberspace, siç është strukturuar dhe rregulluar, është një lloj “*kutie e zezë*”, në të cilën grumbullohen sasi të mëdha të dhënash, informacionesh dhe veprimesh, mbi të cilat përdoruesit standardë nuk kanë mundësi reale kontrolli.³¹ Në hapësirën kibernetike, siç vërehet nga Laërence Lessig në esenë e tij të famshme «E drejta e kalit»³², të dhënat mbledhen pa dijeninë e tyre, duke penguar kështu përdoruesin standard të zgjedhë nëse duhet të marrë pjesë apo të pranojë këtë sistem përgjimi.³³ Këto metoda të mbledhjes, përpunimit dhe administrimit të të dhënave çojnë në një përmbysje të fuqisë tradicionale të zotësisë mbi të dhënat e teorizuara nga Lessig, teorikisht, i përket pronarit të të dhënave, të cilat, në fakt, janë në vend të kësaj në zotërim të bartësve të IT-së dhe burimeve kompjuterike.³⁴

3. Tipologjitë kryesore të dhunës kibernetike

Në praktikë, aktet e dhunës kibernetike mund të përfshijnë lloje të ndryshme ngacmimi, përndjekje, shkelje të privatësisë, abuzim seksual dhe shfrytëzim seksual, urrjetje ndaj grupeve ose komuniteteve shoqërore etj. Dhuna kibernetike mund të përfshijë, gjithashtu, kërcënime të drejtpërdrejta ose dhunë fizike, si dhe forma të ndryshme të krimit kibernetik.³⁵ Nuk ka ende një leksik, apo tipologji të qëndrueshme të veprave të konsideruara si dhunë kibernetike dhe shumë nga shembujt e llojeve të dhunës kibernetike janë të ndërlidhura, mbivendosen apo përbëhen nga një kombinim aktesh. Duhet theksuar se jo të gjitha format ose rastet e dhunës kibernetike janë njësoj të rënda, dhe jo të gjitha kërkojnë domosdoshmërisht një zgjidhje ligjore penale, por mund të trajtohen me një qasje të klasifikuar, një kombinim masash parandaluese, edukative, mbrojtëse apo të tjera.³⁶ Në vijim po trajmë disa nga format më përfaqësuese të dhunës kibernetike.

Ngacmimi kibernetik është, ndoshta, forma më e gjerë e dhunës kibernetike dhe përfshin një sjellje

30 Shih: Edoardo Buffagni “La cyberviolenza è una forma di violenza domestica: come affrontarla”Pubblicato il 10 Feb 2022, La cyberviolenza è una forma di violenza domestica: come affrontarla - Agenda Digitale,.

31 Shih Th. Casadei, Corpi, soggetti, reti: una mappa sommaria delle sfide del presente, in Gf. Zanetti – Th. Casadei, Manuale di filosofia del diritto, cit., p. 401)

32 Shih Frank H. Easterbrook, Cyberspace and the Law of the Horse, 1996 U. CHI. LEGAL F. 207. The reference is to an argument by Gerhard Casper, who, when he was dean of the University of Chicago Law School, boasted that the law school did not offer a course in “The Law of the Horse.” Id. at 207 (internal quotation marks omitted). The phrase originally comes from Karl Llewellyn, who contrasted the U.C.C. with the “rules for idiosyncratic transactions between amateurs.” Id. at 214.

33 Shih V. Colomba, I diritti nel Cyberspazio. Architetture e modelli di regolamentazione. Con un saggio di Lawrence Lessing, Diabasis, Parma, 2015, pp. 75 e ss., in part. fq. 81

34 Shih: Edoardo Buffagni “La cyberviolenza è una forma di violenza domestica: come affrontarla”Pubblicato il 10 Feb 2022, La cyberviolenza è una forma di violenza domestica: come affrontarla - Agenda Digitale,.

35 Cybercrime Convention Committee (T-CY) Working Group on cyberbullying and other forms of online violence, especially against women and children Mapping study on cyberviolence with recommendations adopted by the T-CY on 9 July 2018, fq 6

36 Shih <https://www.coe.int/en/web/cyberviolence>

të vazhdueshme, të përsëritur, e cila synon një person specifik, që është krijuar për të dhe shkakton shqetësime të rënda emocionale, si dhe frikë nga dëmtimi fizik. Ngacmimi kibernetik shpesh realizohet nga një “stuhi abuzimi”.³⁷ Ngacmuesit terrorizojnë viktimat duke kërcënuar me dhunë, postojnë gënjeshtër, apo materiale me përmbajtje shpifëse për t’i shkaktuar viktimës siklet ose më keq midis miqve, familjes ose bashkëpunëtorëve. Ndonjëherë, ngacmuesit manipulojnë motorët e kërkimit për të siguruar lidhjen e gënjeshtërve në kërkimet e emrave të viktimave. Ata pushtojnë privatësinë e viktimave duke postuar informacionet e tyre të ndjeshme, të tilla si imazhe nudo ose numra të identitetit kombëtar.³⁸ Ngacmimi kibernetik, në shumë raste, mund të përshkruhet ose lidhet me “pornografi hakmarrëse”.³⁹

Bullizimi kibernetik është një formë ngacmimi kibernetik, që tentohet të lidhet me viktimë që janë fëmijë, shpesh, të moshës së shkollës së mesme, ndërsa fenomene të tilla si sulmi kibernetik, seksortimi ose «pornografia hakmarrëse» kanë më shumë gjasa të lidhen me të rriturit ose të rinjtë. Kufijtë midis tyre nuk janë të dallueshëm dhe nuk ka marrëveshje të përbashkët se kur të përdoren, cilat terma. Jo të gjitha format e ngacmimit kibernetik përbëjnë domosdoshmërisht një vepër penale. Fenomeni i bullizmit karakterizohet nga veprime të dhunshme dhe frikësuese, si agresioni verbal dhe fizik, format e persekutimit, sjelljet arrogante, të pacipa dhe të përjashtimit social, të kryera me dashje dhe në mënyrë të përsëritur nga një ose shumë persona ndaj një viktime.⁴⁰⁴¹ Për këtë arsye, nga perspektiva e hetimit dhe ndjekjes penale, është thelbësore të bëhet dallimi midis llojeve të ndryshme të bullizmit kibernetik dhe është, gjithashtu, e rëndësishme të bëhet dallimi midis roleve të ndryshme që luajnë individët në një akt të caktuar.

Bullizimi kibernetik përkufizohet në faqen e internetit “Të drejtat e fëmijëve” të Këshillit të Evropës⁴² si përdorimi i teknologjive elektronike për të ngacmuar një person tjetër përmes internetit. Ajo merr formë të ndryshme, që përfshijnë mesazhe të këqija me tekst ose email, thashetheme të dërguara me email ose të postuara në faqet e rrjeteve sociale dhe fotografi, video ose faqe interneti të turpshme

Autorë të ndryshëm kanë dhënë përkufizime të ndryshme të bullizmit kibernetik që mund të konsiderohet gjerësisht si “çdo sjellje e kryer përmes mediave elektronike ose dixhitale nga individë ose

37 Cybercrime Convention Committee (T-CY) Working Group on cyberbullying and other forms of online violence, especially against women and children Mapping study on cyberviolence with recommendations adopted by the T-CY on 9 July 2018, fq 7

38 Shih Citron, Danielle K. *Addressing Cyber Harassment: An Overview of Hate Crimes in Cyberspace*. University of Maryland Francis King Carey School of Law Legal Studies Research Paper, No. 2017-9, 2. See also “the Disturbing Rise of Cyberattacks against Abortion Clinics” in WIRED (10 May 2024)

<https://www.wired.com/story/cyberattacks-against-abortion-clinics/>

39 <https://www.coe.int/en/web/cyberviolence/types-of-cyberviolence>

40 Shih: El Asam, Aiman; Samara, Muthanna. *Cyberbullying and the law: A review of psychological and legal challenge*. Computers in Human Behavior 65 (2016) 127-141.

41 Një shembull i fundit i dhunës kibernetike është sfida “Balena Blu”, e cila është e strukturuar sipas linjave të një videolajë ku pjesëmarrësve u jepen pikë. Fëmijët abonohen në një faqe interneti për t’u kontaktuar nga një “kurator”, i cili do të vendosë 50 detyra që duhet të përmbushen në 50 ditët në vijim. Këto detyra përfshijnë shumë aktivitete, të tilla si shikimi i videove me përmbajtje jashtëzakonisht të dhunshme ose marrja e selfie-ve në situata veçanërisht të rrezikshme (p.sh. në krye të një ndërtese ose afër hekurudhave ose autostradave), por gjithashtu shtrihen deri në vetëlëndim me objekte të mprehta. Detyra e fundit është të kryeni vetëvrasje. Sfida e Balenës Blu duket të jetë e ngjashme me “përkujdesjen” (shih më poshtë); sidoqoftë, “grooming” lidhet në mënyrë tipike në ligjin penal me aktivitetin seksual dhe “Balena Blu” përqendrohet në “prerjen” dhe vetëdëmtimin.

42 <http://www.coe.int/en/web/children/bullying> (link last checked on April 3rd 2024).

grupe që komunikojnë vazhdimisht mesazhe armiqësore ose agresive që synojnë të shkaktojnë dëm ose shqetësim te të tjerët”.⁴³

Viktimat e bullizmit kibernetik përfshijnë gazetarët. Studimi i fundit i Këshillit të Evropës mbi “gazetarët nën presion”⁴⁴ tregoi se gazetarët në më shumë se gjysmën e 47 shteteve anëtare kanë përjetuar ngacmim kibernetik gjatë tre viteve të fundit. Kështu, ngacmimi kibernetik ndikon edhe në lirinë e shprehjes. Nga njëra anë disponueshmëria e disa pajisjeve të afta për të krijuar dhe shkëmbyer imazhe intime kanë sjellë krijimin e matërialeve me përmbajtje pornografike të krijuar nga përdoruesit.⁴⁵ Nga ana tjetër, prodhimi dhe shkëmbimi i imazheve eksplicite seksuale mund të përdoret për aktivitete kriminale si përndjekja në internet, “pornografia hakmarrëse”, biseda me seks,⁴⁶ dhe grooming që përshtaten në kategorinë e përgjithshme të ngacmimeve kibernetike dhe që synojnë kryesisht gratë dhe vajzat.

“*Pornografi hakmarrëse*”⁴⁷ është një term, i cili përqendrohet në portretizimin e qartë seksual të një ose më shumë personave, që shpërndahet pa pëlqimin e subjektit. Fenomeni përfshin kryesisht një partner në një marrëdhënie intime, i cili shpërndan materialin e tillë për të poshtëruar ose frikësuar viktimën. Fenomeni, u shfaq qysh në vitet 1980 (duke qenë një artikull i rregullt në revistën Hustler) dhe u lidh me «pornografinë amatore», përpara se të shndërrohej në video eksplicite seksuale të shpërndara në internet (siç është grumbulluesi amator i pornografisë Xtube në 2008).⁴⁸

43 Shih Tokunaga, Robert S. *Following you home from school: A critical review and synthesis of research on cyberbullying victimization*. Computers in Human Behavior, 26(3), 278. Pwr mw shumw shih Van Leeuwen, J.C. Literature review on the research on cyberbullying definitions. Universiteit Twente. (2012). MOORE, Michael J.; NAKANO Tadashi; ENOMOTO Akihiro; SUDA Tatsuya. *Anonymity and Roles Associated with Aggressive Posts in an Online Forum*. Computers in Human Behavior (2012). JUVONEN, Jaana; GROSS Elisheva F. *Extending the School Grounds?-Bullying Experience in Cyberspace*. Journal of School Health. Vol. 78(9). (2008), 496-505. BESLEY, Bill. Published on <http://www.cyberbullying.ca/> (link last checked 5th of April 2024). SMITH, Peter K.; MAHDAVI Jess; CARVALHO Manuel; FISHER Sonja; RUSSELL Shanette; TIPPETT Neil. *Cyberbullying: its nature and impact in secondary school pupils*. The Journal of Child Psychology and Psychiatry. Vol. 49(4). (2008), 376-385. KOWALSKI, Robin M.; LIMBER, Susan P. *Electronic Bullying Among Middle School Students*. Journal of Adolescent Health 41 (2007) S22-S30. ERDUR-BAKER, Özgür. *Cyberbullying and its correlation to traditional bullying, gender and frequent and risky usage of internet-mediated communication tools*. New Media & Society. Vol. 12(1). (2009), 109-125.

